



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

4339

Nr.06/ \_\_ 2026

DATE:	12.05.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizim, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim-Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kanioni” Dremjak-Hani i Elezit

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkresë përcjellëse po ju përcjellim Propozim-Vendimin për marrjen nën mbrojtje të vlerës së natyrës “Kanioni” në Dremjak komuna Hani i Elezit.

Bashkëlidhur me shkresën kenë:

- Propozim-Vendimin,
- Raportin nga shqyrtimi publik i vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e komunës Hani i Elezit, të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- Pëlqimin paraprak me nr.1243-2/26 nga MMPH për vënie nën mbrojtje të katër vlerave të trashigimisë natyrore, si dhe:
- Një material të shkurtër me foto të monumenteve natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore.

Me respekt.



01Nr. \_\_\_\_\_/2026

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010, nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008) dhe nenit 11 pika sh e Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Nr. 01/4240/2023 të datës 30.05.2023, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me dt: xx.xx.2026 merr këtë:

### PROPOZIM-V E N D I M

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës: **“Kanioni”** në Dremajk të Hanit të Elezit si Monument i Natyrës


1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **“Kanioni”**, në fshatin Dremjak të Hanit të Elezit, si Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
  - 1.1. Monumenti i Natyrës me sipërfaqen prej **0.24 hektar** si zonë mbrojtëse.
  - 1.2. Monumenti i Natyrës është me karakter hidrologjik dhe ka pamje karakteristike. Kanioni është i kufizuar me shkëmbinj serpentini dhe përreth tij gjendet vegjetacioni bimorë me lloje të ndryshme që rriten në zona shkëmbore dhe ujore.
  - 1.3. Kanioni gjendet në koordinatat: X – 0526019, Y – 4668755 dhe Z – 607.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur “Skallavac”, në parcelën me nr. P-73317034-00574-0 00574-0, me sip.18695m<sup>2</sup> zona kadastrale Dremajk, përndryshe pronw shoqërore e P.Sh. “Ujrat”.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtjes i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
  - 4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
    - a) Dëmtimi, shkatërrimi dhe bartja e pjesëve shkëmbore, si dhe ndryshimi i formës së tij;
    - b) Për të gjitha aktivitetet në Monumentin e Natyrës duhet të merret leja nga Ministria, posaçërisht për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale;
    - c) Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës;
5. Monumenti i Natyrës mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
  - 5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
    - a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror do të ndërmerren sipas kushteve të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Hanit të Elezit përmes drejtorisë përkatëse.
  - 6.1. Komuna është e detyruar që:
    - a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
    - b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
    - c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura;
1. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.
2. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe shtatë (7-të) ditë pas publikimit në ëb-faqen zyrtare të komunës së Hanit të Elezit.

Hani i Elezit  
Data: xx.xx.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

---



Harta e Monumentit Natyror “Kanioni”, në Drenjak



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

4330

Nr.06/ \_ 2026

DATE:	12.05.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci – Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim-Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungu i Bungëbutës” në Dromjak-Hani i Elezit

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim Propozim-Vendimin për marrjen nën mbrojtje të vlerës së natyrës “Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens)” në Dromjak komuna Hani i Elezit.

Bashkëlidhur me shkresën keni:

- Propozim-Vendimin,
- Raportin nga shqyrtimi publik i vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e komunës Hani i Elezit, të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- Pëlqimin paraprak me nr.1243-2/26 nga MMPH për vënie nën mbrojtje të katër vlerave të trashigimisë natyrore, si dhe:
- Një material të shkurtër me foto të monumenteve natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore.

Me respekt.



01Nr. \_\_\_\_\_/2026

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010, nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008) dhe nenit 11 pika sh e Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Nr. 014240/2023 të datës 30.05.2023, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me dt: xx.xx.2026 merr këtë:

### PROPOZIM-V E N D I M

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “**Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*)**” në Dremjak të Hanit të Elezit si Monument i Natyrës


1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës “**Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*)**”, në fshatin Dremjak të Hanit të Elezit, si Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
  - 1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse rreth projeksionit të kurorës prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej **5 ari**.
  - 1.2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë për territorin e komunës së Hanit të Elezit. Trungu gjenden në këto koordinata: X – 0525441, Y – 4668999, Z – 696.
  - 1.3. Lartësia e kërcellit të Monumentit Natyror është rreth 32metra, perimetri i kërcellit është 3.5 metra, diametri i kurorës 14 metra dhe vjetërsia është mbi 350 vite.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në parcelen me nr. P-73317034-00371 zona kadastrale Dremjak, me sipërfaqe 8960 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pronë shoqërore P.Sh.Ekonomia e Pyjeve.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtjes i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
  - 4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
    - a) Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
    - b) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
    - c) Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
    - d) Ndryshimi i pamjes të sipërfaqes së mbrojtur;
    - e) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
    - f) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës;

- g) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
  - h) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
  - i) Ndërrimi i kulturës;
  - j) Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror;
5. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
- 5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
- a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.
6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Hanit të Elezit, përmes drejtorisë përkatëse.
- 6.1. Komuna është e detyruar që:
- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
  - b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
  - c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura;
1. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.
2. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe shtatë (7-të) ditë pas publikimit në ëb-faqen zyrtare të komunës së Hanit të Elezit.

Hani i Elezit

Data:xx.xx .2026

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta



Harta e Monumentit Natyror “Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*)”, në Dramjak



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

4334

Nr.06/ \_\_ 2026

DATE:	12.05.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Elez
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim-Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kepi i gjatë dhe burimi i ujit” Pustenik

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim Propozim-Vendimin për marrjen nën mbrojtje të vlerës së natyrës “Kepi i gjatë dhe burimi i ujit” në Pustenik komuna e Hanit të Elezit.

Bashkëlidhur me shkresën keni:

- Propozim-Vendimin,
- Raportin nga shqyrtimi publik i vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e komunës Hani i Elezit, të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- Pëlqimin paraprak me nr.1243-2/26 nga MMPH për vënie nën mbrojtje të katër vlerave të trashigimisë natyrore, si dhe:
- Një material të shkurtër me foto të monumenteve natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore.

Me respekt.



01Nr. \_\_\_\_\_/2026

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010, nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008) dhe nenit 11 pika sh e Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Nr. 01/4240/2023 të datës 30.05.2023, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me dt: xx.xx.2026 merr këtë:

## V E N D I M

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës: **“Kepi i gjatë dhe burimi i ujit”** në Pustenic të Hanit të Elezit si Monument i Natyrës

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **“Kepi i gjatë dhe burimi i ujit”**, në fshatin Pustenic të Hanit të Elezit, si Monument i Natyrës i karakterit gjeomorfologjik dhe hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
  - 1.1. Monumenti i Natyrës me sipërfaqen prej **4.1 hektarsi** zonë mbrojtëse.
  - 1.2. Monumenti i Natyrës është me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik me pamje karakteristike. Kepi i gjatë dhe burimi i ujit është i kufizuar me vegjetacion bimor me lloje të ndryshme që rriten në zona shkëmbore, si dhe rrjedha ujore të pasura me bimësi.
  - 1.3. Kepi i gjatë dhe burimi i ujit gjenden në koordinatat: X –0520640, Y – 4669909 dhe Z – 612.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur “Laç”, në pronë shoqërore PSh Ekonomia e Pyjeve, në parcelën me nr. P-73317070-00099-0, me sipërfaqe 266189 m<sup>2</sup> z.k Pustenic.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtës i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
  - 4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
    - a) Dëmtimi, shkatërrimi dhe bartja e pjesëve shkëmbore, si dhe ndryshimi i formës së tij;
    - b) Për të gjitha aktivitetet në Monumentin e Natyrës duhet të merret leja nga Ministria, posaçërisht për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale;
    - c) Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës;
5. Monumenti i Natyrës mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
  - 5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
    - a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për


sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Hanit të Elezit përmes drejtorisë përkatëse.
  - 6.1. Komuna është e detyruar që:
    - a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
    - b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
    - c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura;
1. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.
2. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe shtatë (7-të) ditë pas publikimit në web-faqen zyrtare të komunës së Hanit të Elezit.

Hani i Elezit  
Data:xx.xx.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

---



Harta e Monumentit Natyror "Kepi i gjatë dhe burimi i ujit", në Pustenik



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

4338

Nr.06/\_ 2026

DATE:	12.05.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunes Han i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim Informatën mbi Gjendjen në Mjedis në Han të Elezit për vitin 2025. Bashkëlidhur me shkresën keni Informatën e përgaditur nga DUKMM.

Me Respekt.

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJA E MJEDISIT

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY	
HAN I ELEZIT	
Nr. i Prot.	06/9251
Nr. i Faq.	40
Data	08.05.26

**INFORMATË MBI GJENDJEN NË MJEDIS  
NË HAN TË ELEZIT PËR VITIN 2025**

*Hani i Elezit  
Maj 2026*

## HYRJE

### “TË MBROJMË MJEDISIN PËR TË ARDHMËN TONË DHE VENDIN KU JETOJMË”

*Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit (DUKMM) gjegjësisht Komuna e Hanit të Elezit, bazuar në mundësitë dhe kapacitetet e saja profesionale dhe financiare, në vazhdimësi përcjellë dhe ndërmer masa për parandalimin dhe përmirsimin e gjendjes mjedisore siq janë: investimet kapitale publike të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e ambientit, ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në lum dhe prrocka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë. Pavarësisht kësaj, vitin 2025 ndotja e ambientit është pa ndryshime të mëdha në raport me ndotjen e vitit 2024.*

#### **NDOTJA E AJRIT**

*Është e njohur se ndotësit kryesor të ajrit në Han të Elezit janë fabrika për prodhimin e çimentos SharrCem, numri i madh i veturave dhe mauneve të vjetra në qarkullim, përdorimi në masë të madhe i masës drusore për ngrohje gjatë sezonit dimëror, gurëthyesit, mbetjet e azbestit të shpërndara gjithandej territorit etj.*

*Përndryshe, monitorimi i cilësisë së ajrit në Han të Elezit, bëhet nga IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës) përmes stacionit për monitorim i vendosur në oborrin e shkollës fillore “Ilaz Thaçi”. Ky stacion është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin urban dhe përmes tij monitorohen këto parametra: dioksidi i sulfurit (SO<sub>2</sub>), dioksidi i azotit (NO<sub>2</sub>) ozoni(O<sub>3</sub>), monoksidi i karbonit (CO), grimcat e imta PM10 dhe PM2.5. Po ashtu monitorimi i ajrit bëhet edhe nga stacioni për monitorim i Sharrcem, i vendosur në hapësirat e brendshme të saja.*

Ky stacion është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin industrial dhe përveç parametrave të lartpërmendur bënë matjen edhe të Oksideve të Sqfurit ( $SO_x$ ), Oksidet e Azotit ( $NO_x$ ), si dhe pluhurit që emetohet nga oxhaku i furrës, ftohësi i klinkerit dhe mullinjtë e çimentos. Sharrcem, në baza të rregullta mujore, raportet e monitorimit të ajrit ia përcjellë Drejtorisë së Mjedisit respektivisht inspektore Komonale për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërkaq MMPH-ja këto raporte i publikon në faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK).

Më poshtë po japim Normat e Cilësisë së Ajrit sipas udhëzimit administrativ Nr.02/2011, si dhe rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni i IHMK.

#### Normat e cilësisë së ajrit sipas udhëzimit administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësi a matë se	Vlera limite (kufitare) $\mu/m^3$	Tejkalimet e lejuara për ditë brenda vitit
NO <sub>2</sub>	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu g/m^3$	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu g/m^3$	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore për mbrojtjen e vegjetacionit	$\mu g/m^3$	30	Nuk parashihet
SO <sub>2</sub>	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu g/m^3$	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu g/m^3$	125	3
CO	Vlera limite për mesatarën ditore të maksimales 8 orëshe për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu g/m^3$	10	Nuk parashihet

$PM_{10}$	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	50	35
$PM_{2.5}$	Vlera limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
	Viti kalendarik	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	25	Nuk parashihet
$O_3$	Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	240	Nuk parashihet

*Indexi i Cilësisë së Ajrit sipas standardeve të BE-s*

<i>Cilësia</i>	<i>Shumë e Mirë</i>	<i>E Mirë</i>	<i>E moderuar</i>	<i>E pashëndetshme</i>	<i>E rrezikshme për shëndetin</i>
<i>Grimcat e pluhurit më të vogla se 2. (<math>PM_{2.5}</math>)</i>	<i>0-10</i>	<i>10-20</i>	<i>20-25</i>	<i>20-50</i>	<i>50-800</i>
<i>Grimcat e pluhurit më të vogla se 10<math>\mu\text{m}</math> (<math>PM_{10}</math>)</i>	<i>0-20</i>	<i>20-35</i>	<i>35-50</i>	<i>50-100</i>	<i>100-1200</i>
<i>Dioxidi i azotit (<math>NO_2</math>)</i>	<i>0-40</i>	<i>40-100</i>	<i>100-200</i>	<i>200-400</i>	<i>400-1000</i>
<i>Ozoni (<math>O_3</math>)</i>	<i>0-80</i>	<i>80-120</i>	<i>120-180</i>	<i>180-240</i>	<i>240-600</i>
<i>Dioksidi i Sulfurit (<math>SO_2</math>)</i>	<i>0-100</i>	<i>100-200</i>	<i>200-350</i>	<i>350-500</i>	<i>500-1250</i>
<i>Niveli i indexit i bazuar 5<math>\mu\text{m}</math> në përqëndrimin e ndotësve shprehur në <math>\mu\text{g}/\text{m}^3</math></i>					

**REZULTATET E MONITORIMIT TË CILËSISË SË AJRIT NGA STACIONI  
I IHMK PËR VITIN 2024**

**Dioksidi i Sulfurit SO<sub>2</sub> (µg/m<sup>3</sup>)**

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	10 µg/m <sup>3</sup>	8.2 µg/m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	22 µg/m <sup>3</sup> (dhjetor)	27 µg/m <sup>3</sup> (janar)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	3 µg/m <sup>3</sup> (tetorj)	4 µg/m <sup>3</sup> (mars)
<i>Vlera max. per nje orë</i>	95 µg/m <sup>3</sup> (06.05.2024)	200 µg/m <sup>3</sup> (04.07.2025)

**Monoksidi i Karbonit CO (µg/m<sup>3</sup>)**

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	0.50 µg/m <sup>3</sup>	0.59 µg/m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	1 µg/m <sup>3</sup> (janar)	1.1 µg/m <sup>3</sup> (Janar)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	0.2 µg/m <sup>3</sup> (prill)	0.3 µg/m <sup>3</sup> (shtator)
<i>Vlera max. 8 orëshe</i>	2.2 µg/m <sup>3</sup> (05.01.2024)	2.3 µg/m <sup>3</sup> (02.01.2025)

**Dioksidi i Azotit NO<sub>2</sub> (µg/m<sup>3</sup>)**

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	14.25 µg/m <sup>3</sup>	10.75 µg/m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	20 µg/m <sup>3</sup> (nëntor)	24 µg/m <sup>3</sup> (janar)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	9 µg/m <sup>3</sup> (prill)	6 µg/m <sup>3</sup> (shtator)
<i>Vlera max. për një orë</i>	70 µg/m <sup>3</sup> (27.02.2024)	78 µg/m <sup>3</sup> (05.05.2025)

### Ozoni (O<sub>3</sub>) (mg/m<sup>3</sup>)

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	52.5 mg/m <sup>3</sup>	51.8 mg/m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	81 mg/m <sup>3</sup> (korrik)	85 mg/m <sup>3</sup> (korrik)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	28 mg/m <sup>3</sup> (dhjetor)	23 mg/m <sup>3</sup> (nëntor)
<i>Vlera max. për një orë</i>	151mg/m <sup>3</sup> (01.08.2024)	155mg/m <sup>3</sup> (16.06.2025)

### Grimcat PM10 (µg/m<sup>3</sup>)

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	15.3 µg /m <sup>3</sup>	13.3 µg /m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	26 µg/m <sup>3</sup> (janar)	29 µg/m <sup>3</sup> (janar)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	9 (maj)	7 (Maj)
<i>Vlera maksimale për një ditë</i>	49 µg/m <sup>3</sup>	58 µg/m <sup>3</sup>
<i>Data e vlerës maksimale e mesatares ditore</i>	01.01.2024 viti	02.01.2025 viti

### Grimcat PM2.5 (µg/m<sup>3</sup>)

<b>Emertimi</b>	<b>Viti 2024</b>	<b>Viti 2025</b>
<i>Vlera mesatare vjetore e emetimit</i>	11.08 µg/m <sup>3</sup>	10.7 µg/m <sup>3</sup>
<i>Muaji me vlerën mesatare më të lartë</i>	23 µg/m <sup>3</sup> (janar)	27 µg/m <sup>3</sup> (janar)
<i>Muaji me vlerën mesatare më të ulët</i>	6 µg/m <sup>3</sup> (shtator)	4 µg/m <sup>3</sup> (maj)
<i>Vlera maksimale për një orë</i>	94 µg/m <sup>3</sup>	81 µg/m <sup>3</sup>
<i>Data e vlerës maksimale</i>	23.04.2024 viti	02.01.2025 viti

## ***VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT GJATË VITIT 2025, BAZUAR NË TË DHËNAT E MONITORIMIT NGA IHMK***

*Ky vlerësim përfshinë vlerat mesatare vjetore dhe të njejtat janë krahasuar me vlerat maksimale të lejuara (VLM) sipas U.A 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit si dhe krahasimin me vitin paraprak. Nga të dhënat për matjen e përqendrimit të*

ndotësve në ajër mund të konstatohet se vitin 2025 janë regjistruar katër ditë me tejkalime të vlerave max. Për 24h të  $PM_{10}$  dhe atë: në muajin janar janë regjistruar 3 ditë me tejkalime dhe një ditë në muajin dhjetor. Vlera max. prej  $58 \mu\text{g}/\text{m}^3$  është regjistruar me dt.02.01.2026. (Vitin 2024 nuk është regjistruar asnjë ditë me tejkalime të  $PM_{10}$ ). Vlera mesatare vjetore e  $PM_{10}$  prej  $13.3 \mu\text{g}/\text{m}^3$  sipas indexit të cilësisë së ajrit sipas standardeve të BE-s cilësohet si : E MIRË ( $10-20 \mu\text{g}/\text{m}^3$ , shiqo tabelen në faqen 2 Indexi i Cilësisë Ajrit- Standardet Evropiane). Tejkalime mbi vlerat e lejuara janë regjistruar te Ozoni. Në korrik janë regjistruar 65 orë me tejkalime , në gusht 17orë dhe shtator 4 orë. Vlera max. e Ozonit për një orë është regjistruar me dt.16.06.2025 dhe ka arritë në  $155 \mu\text{g}/\text{m}^3$ . Pavarësisht kësaj, vlerat mesatare vjetore të përqëndrimit të ndotësve në ajër janë më të ulta se vlerat limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Kjo vlenë për gjithë ndotësit si: dioksidin e sulfurit, monoksidin e karbonit, dioksidin e azotit, ozonin,  $PM_{10}$  dhe  $PM_{2.5}$ .

**Më poshtë po japim parametrat e monitorimit të cilësisë së ajrit (mesataret mujore) për Monoksidin e Karbonit,  $PM_{10}$  dhe  $PM_{2.5}$  për mujt shkurt, mars, prill (koha kurrë mulliri i lëndës dhe furra e çimentos nuk kanë punuar për shkak të remontit) dhe krahasimi me muajt tjerë të vitit kurrë SharrCem ka punuar me kapacitete normale:**

**Mesataret mujore për CO,  $PM_{10}$  dhe  $PM_{2.5}$**

	Jan	Shk	Mar	Pril	Maj	Qer	Kor	Gus	Shta	Teto	Në	Dhje
	n	u	r	l	j	r	r	h	t	r	n	t
CO $\mu\text{g}/\text{m}^3$	1.1	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.3	0.3	0.3	0.4	0.5	0.8
$PM_{10}$ $\mu\text{g}/\text{m}^3$	29	25	15	8	7	10	8	8	7	9	12	22
$PM_{2.5}$ $\mu\text{g}/\text{m}^3$	27	22	11	6	4	7	5	5	4	7	10	21

Nëse i referohemi të dhënave të lartëparaqitura atëherë mund të konstatohet se perceptimi i një numri të konsiderueshëm të qytetarëve se fabrika e çimentos është burimi kryesor dhe pothuajse i vetmi i ndotjes së ajrit në Han të Elezit është i gabuar. Me siguri se qarkullimi i madhë i automjeteve (karburante fosile) i kombinuar me përdorimin masiv të masës drusore për ngrohje në sezonin e dimrit kanë një impakt të madhë në ndotjen e ajrit.

### **REZULTATET E NDOTJES NGA $PM_{10}$ dhe $PM_{2.5}$ NË DISA QYTETE TË KOSOVËS DHE KRAHASIMI ME HANIN E ELEZIT**

*Tabela krahasuese për vitin 2025 vlera mesatare vjetore*

<i>Vendi</i>	<i><math>PM_{10}</math> (<math>\mu\text{g}/\text{m}^3</math>) (mesatarja vjetore)</i>	<i><math>PM_{2.5}</math> (<math>\mu\text{g}/\text{m}^3</math>) (mesatarja vjetore)</i>
<i>Hani Elezit</i>	<i>13.3</i>	<i>10.7</i>
<i>Prishtinë (Rilindja)</i>	<i>28</i>	<i>20</i>
<i>Prishtinë (IHMK)</i>	<i>20</i>	<i>15.4</i>
<i>Mitrovicë</i>	<i>21.4</i>	<i>16.5</i>
<i>Gjilan</i>	<i>17.9</i>	<i>14.6</i>
<i>Obiliq</i>	<i>16.5</i>	<i>11.8</i>
<i>Prizren</i>	<i>12.5</i>	<i>9.75</i>

*Edhe pse vlerat e regjistruara të ndotjes së ajrit nga  $SO_2$ ,  $CO$ ,  $NO_2$ ,  $O_3$ ,  $PM_{2.5}$  dhe  $PM_{10}$  sipas rezultateve nga stacioni për monitorimin e cilësisë së ajrit (i vendosur në oborrin e shkollës fillore) janë brenda limiteve dhe standardeve të përcaktuara me U/A 02/2011 (vlerat mesatare vjetore) na besojmë se këto rezultate nuk pasqyrojnë drejtë nivelin e ndotjes i cili ekziston në pjesë të caktuara të qytetës e sidomos në lagjet në afërsi të SharrCem dhe magjistrales Prishtinë-Shkup (pjesa verilindore e Hanit të Elezit). Këto vlera më të larta të përqëndrimit të këtyre ndotësve në ajrë kryesisht i atribuohen qarkullimit të madhë të veturave dhe mauneve në autoudhën dhe magjistralen Prishtinë-Shkup, ndotjes*

nga industria (SharrCem, gurëthyesit) ngrohjes me masë drusore gjatë sezonit të dimrit si dhe kushteve të pafavorshme meteorologjike

### **NDOTJA E TOKËS dhe UJIT**

Për sa i përket ndotjes së tokës dhe ujit, nuk ka ndryshime thelbësore në raport me vitin 2024. Edhe më tutje territori i Hanit të Elezit ( në veçanti toka në zonën urbane) është e kontaminuar nga ndotja afatgjate si rezultat i emetimit të pluhurit dhe substancave tjera të dëmshme nga fabrika e çimentos për më shumë se tetë dekada të funksionimit të saj. Edhe më shumë të dëmshme janë mbetjet e azbestit të përhapura gjithëandej Hanit të Elezit e më së shumti në brigjet e lumit Lepenc, si rezultat i operimit të Sharr-Sallonitit në vitet e tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta.

Për sa i përket ndotjes së ujit edhe më tutje shqetësuese është ndotja e lumit Lepenc nga mbeturinat e patrajtuara të sistemit të ujrave të zeza e kombinuar me ndotjen kimike nga industrinë në këtë regjion. Përndryshe ndotja e lumit Lepenc renditet në kategorinë dy dhe tre nga katër kategoritë e klasifikimit.

### **SEKTORI I MJEDISIT**

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë kryer inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit lidhur me ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në natyrë, lum dhe procka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë të ambientit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë.

Me kërkesë të zyrtarëve të MMPHI-së, departamenti për Mbrojtjen e Natyrës, kemi bërë identifikimin e vlerave të trashëgimisë natyrore në komunën tonë.

Sektori i Mjedisit duke u bazuar në Planin Lokal për Veprim në Mjedis – listën e aktiviteteve, ka shënuar Ditën Ndërkomtare të Tokës së bashku me kompaniSharrcem me një sërë aktiviteteve vetëdijësuese me nxënësit e shkollës fillore, ligjërata, mbjellje drunjësh, lule etj. që japin mesazhe për mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit.

---

*Kjo informatë është hartuar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i ndihmuar nga zyrtarja për Mjedis Fatbardha Bushi.*

HANI I ELEZIT  
MAJ 2026





REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

4337

Nr.06/ \_\_ 2026

DATE:	12.05.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunes Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci – Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim-Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Parku dhe Ujëvara” në Han i Elezit

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim Propozim-Vendimin për marrjen nën mbrojtje të vlerës së natyrës “Parku dhe Ujëvara” në Han të Elezit.

Bashkëlidhur me shkresën kenë:

- Propozim-Vendimin,
- Raportin nga shqyrtimi publik i vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e komunës Hani i Elezit, të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- Pëlqimin paraprak me nr.1243-2/26 nga MMPH për vënie nën mbrojtje të katër vlerave të trashigimisë natyrore, si dhe;
- Një material të shkurtër me foto të monumenteve natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore.

Me respekt.



01/Nr. \_\_\_\_/2026

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.85/2010, nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008) dhe nenit 11 pika sh e Statutit të Komunës të Elezit, nr.01 /4240/2023 të datës 30.05.2023, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me dt: xx.xx.2026, merr këtë:

### PROPOZIM-VENDIM

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës: **“Parku dhe Ujëvara”** në qytetin e Hanit të Elezit si Monument i Natyrës

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **“Parku dhe Ujëvara”** në qytetin e Hanit të Elezit, si Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
  - 1.1. Monumenti i Natyrës me sipërfaqen prej **27 ari** si zonë mbrojtëse.
  - 1.2. Monumenti i Natyrës është me karakter hidrologjik dhe ka pamje karakteristike. Parku ka pamje interesante, kurse lartësia e Ujëvarës është rreth pesë metra dhe përreth saj gjendet vegjetacioni bimorë me lloje të ndryshme.
  - 1.3. Parku dhe Ujëvara gjendet në koordinatat: X –0525138, Y – 4666926 dhe Z – 412.
2. Monumenti i Natyrës: “Parku dhe Ujëvara” gjendet në afërsi të depos së vjetër ushtarake, në parcelen me nr. P-73317036-00061-16 me sip.47419m<sup>2</sup> z.k. Hani i Elezit, përndryshe pronë e Republikës së Kosovës e dhënë në shfrytëzim afatgjatë komunës Hani i Elezit.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtjes i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
  - 4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
    - a) Dëmtimi, shkatërrimi dhe bartja e pjesëve shkëmbore, si dhe ndryshimi i formës së tij;
    - b) Për të gjitha aktivitetet në Monumentin e Natyrës duhet të merret leja nga Ministria, posaçërisht për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale;
    - c) Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës;
5. Monumenti i Natyrës mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
  - 5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
    - a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për


sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Hanit të Elezit përmes drejtorisë përkatëse.
  - 6.1. Komuna është e detyruar që:
    - a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
    - b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
    - c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura;
7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.
8. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe shtatë (7-të) ditë pas publikimit në ëeb-faqen zyrtare të komunës së Hanit të Elezit.


Hani i Elezit  
Data:xx.xx.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

---



Harta e MN Parku dhe Ujëvara në Han të Elezit



Date: 2/11/2025  
 Author: SIM / AMMK



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)  
 Adresa: Rruga "Luara Haradinaj" ish pallati i medieve  
 "Rilindja", kati XV/04, 10000 Prishtinë  
 Tel. 008 200 74 094, e-mail@web: www.ammk-riks.net

**Legend**

- Kufi Shtetror
- Kufi komune
- Parcelë kadastrale
- MN\_Hani\_i\_Elezit**
- Parku dhe Ujëvara

Harta e Monumentit Natyror "Parku dhe Ujëvara", në qytetin e Hanit të Elezit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org Org. Aedimica Org. Unit	SP-02	Nr Prot Broj Prot Prot.No	1243-2/26
Nr. Faqeve Broj stranic No pages	-03-	Data Datum Date	22.06.26 /20 26
PRISHTINE/A			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATE/A:</b>	08. 04. 2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	1243/26, 17.03.2026 MMPH
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Nexhmedin Daci, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizëmit, Kadastërit dhe Mbrojtja e Mjedisit në Komunën e Hanit të Elezit
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Bajram Kafexholli - UD. i Sekretarit të Përgjithshëm MMPH
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Pëlqim paraprak

Sipas kërkesës me numër protokollit 1243/26, 17.03.2026 MMPH dhe me numër protokollit Nr.189/DMM datë 17.03.2025, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si në vijim me Vendimin e bashkangjitur.

Me respekt,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Shtetërore, duke u bazuar në Nenit 19 të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

## V E N D I M

Në kërkesën me numër protokoli Nr.1243/26, 17.03.2026 MMPH, nr. protokoli Nr.189/DMM datë 18.03.2026 për Pëlqim paraprak për vënie nën mbrojtje të vlerave të natyrës nga z.Nexhmedin Daci, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastërit dhe Mbrojtja e Mjedisit, në Komunën e Hanit të Elezit si dhe informatat plotësuese të dërguara nga IKMN-së me datë 07.04.2026 janë prezantuar dokumentacioni dhe shënimet të nevojshme në bazë të Nenit 14 dhe Nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **jep Pëlqim paraprak** për kategorizimin e vlerave të natyrës në Monumente të Natyrës me sa vijon:

1. “Trungut të Bungëbutës (Quercus pubescens)” në kategorinë Monumenti i Natyrës i karakterit botanik në fshatin Dremjak të komunës së Hanit të Elezit, me sipërfaqe të propozuar për mbrojtje prej 5 ari.
2. “Parkut dhe Ujëvarës” në kategorinë Monument i Natyrës me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik në qytetin e Hanit të Elezit, me sipërfaqe të propozuar për mbrojtje prej 27 ari.

Faqe 2 nga 3



3. "Kepit të gjatë dhe burimit të ujit" në kategorinë Monument i Natyrës me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik në fshatin Pustenik të komunës së Hanit të Elezit, me sipërfaqe të propozuar për mbrojtje prej 4.1 ha.
4. "Kanionit" në kategorinë Monument i Natyrës me karakter hidrologjik, Monument i Natyrës në fshatin Dremjak të komunës së Hanit të Elezit, me sipërfaqe të propozuar për mbrojtje prej 0.24 ha.

### Ar sy e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të kërkesës me Nr. 1243/26, 17.03.2026 MMPH dhe Nr.189/DMM datë 18.03.2026 për Pëlqim paraprak për marrje nën mbrojtje të vlerave të natyrës në kategorinë Monumente të Natyrës në Komunën e Hanit të Elezit, janë prezantuar dokumentet dhe shënimet e nevojshme sipas Nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Udhëzim Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimet e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/ 1243/1 - ZSP/

/26 datë: 08. 04. 2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. DMM/DMNB
3. AMMK/IKMN
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPHI
6. DKP

Bajram Kafexholli

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së



**RAPORTI NGA SHQYRTIMI PUBLIK I VLERAVE TË TRASHIGIMISË NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS HANI I ELEZIT TË PROPOZUARA PËR MBROJTJE LIGJORE NGA INSTITUTI PËR MBROJTJEN E NATYRËS**

**HYRJE**

Debati publik i Raportit të Studimeve dhe Evidentimit të Vlerave të Trashigimisë Natyrore në Territorin e Komunës Hani i Elezit, të propozuara për Mbrojtje Ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, është një hap kyq në përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesit në procesin e diskutimeve dhe pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje lidhur me vlerat e trashigimisë natyrore në territorin e komunës. Ky raport është hartuar në pajtim me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës nr.03/L-233, Udhëzimit Administrativë (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe si i tillë përmbledhë rrjedhën e diskutimeve, komenteve, vërejtjeve si dhe propozimeve që dalin nga ky proces i rëndësishëm së veçantë për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Vlerat e trashigimisë natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore e që ishin objekt i këtij shqyrtimi publik janë:

**Lista fillestare e monumenteve të trashigimisë natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore në komunën e Hanit të Elezit**

Nr	Vendi	Objekti	Kordinatat	Kategoria e propozuar për mbrojtje
1.	Hani i Elezit	Parku dhe Ujëvara	x-0525138 y-4666926 z-412	Kategoria III Monument i natyrës me karakter hidrologjik
2.	Dromjak	Kanioni	x-0526019 y-4666926 z-607	Kategoria III Monument I natyrës me karakter geom.-hidrologjik
3.	Dromjak	Trungu i Bungëbutes (Quercus pubescens)	x-0525441 y-4668999 z-696	Kategoria III Monument I natyrës me karakter botanik
4.	Pustenik	Kepi i gjatë dhe burimi i ujit	x-0520640 y-4669909 z-612	Kategoria III Monument I natyrës me karakter geom.-hidrologjik
5.	Gorancë	Trungu i Bungëbutes (Quercus pubescens)	x-0519074 y-4665069 z-683	Kategoria III Monument I natyrës me karakter botanik

**PROCESI I SHQYRTIMIT PUBLIK**

Në pajti me U/A në fuqi, është organizuar debati publik i Raportit të Studimeve dhe Evidentimit të Vlerave të Trashigimisë Natyrore në Territorin e Komunës, të propozuara për Mbrojtje Ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës. Debati është mbajtur nga data 03.02.2026-03.03.2026 (njoftimi publik mbi mbajtjen e debatit publik është publikuar me dt.22.01.2026 viti). Ndërkaq shqyrtimi kryesor publik është mbajtur me dt.03.02.2026 në sallën e takimeve të objekti i komunës me fillim nga ora 10:30 me

pjesmarrjen e 22 individëve: 7 gra dhe 15 burra. Para mbajtjes së debatit publik DUKMM, si bartëse e procesit ka kryer gjitha punët organizative për mbarrvajtje të procesit: Është publikuar në ueb faqen e komunës Njoftimi Publik si dhe Raporti dhe Elaborati i Studimeve dhe Evidentimit të Vlerave të Trashigimisë Natyrore në Komunën e Hanit të Elezit, të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Po ashtu Njoftimi Publik është publikuar edhe në fejsbukun e komunës si dhe në tabelën e shpalljeve. Në funksion të kësaj me shkresa janë njoftuar edhe pronarët e parceleve siq është Agjencioni Kosaovar i Pyjeve si dhe pronari privat i një parcele në fshatin Gorancë ku ndodhet një lis i bungëbutës i propozuar për mbrojtje ligjore.

E gjithë rrjedha e shqyrtimit kryesor publik është përshkruar në procesverbalin e takimit e cila është pjesë e këtij raporti si dhe lista e pjesmarrsve.



## PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE, REKOMANDIMEVE NGA QYTETARËT

Me dt. 03.02.2026 kemi pranuar vetëm një kërkesë respektivisht një ankesë nga z. Isuf Berisha nga fshati Gorancë i cili ka kërkuar që lisi i bungëbutës i cili ndodhet në oborrin e pronës së tij të hiqet nga lista e monumenteve sepse ata kanë plane për ndërtim në atë parcelë. Pas shqyrtimit të ankesës DUKMM së bashku me Institutin e Kosovës e kanë miratuar kërkesën e z. Isuf Berisha kështu që trungu i bungëbutës në fshatin Gorancë hiqet nga lista e propozuar e monumenteve natyrore për mbrojtje ligjore. Me këtë vendim është njoftuar edhe pala. Po ashtu, në bashkëpunim me zyrtarët e Institutit janë korigjuar dhe sip. e parceleve në të cilat ndodhen këto monumente duke definuar saktësisht sipërfaqet. Këto korigjime janë bërë edhe në elaboratet si dhe hartat.

### Lista përfundimtare e monumenteve të trashigimisë natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore në komunën e Hanit të Elezit

Nr	Vendi	Objekti	Kordinatat	Kategoria e propozuar për mbrojtje
1.	Hani i Elezit	Parku dhe Ujëvara	x-0525138 y-4666926 z-412	Kategoria III Monument i natyrës me karakter hidrologjik
2.	Dromjak	Kanioni	x-0526019 y-4666926 z-607	Kategoria III Monument I natyrës me karakter geom.-hidrologjik
3.	Dromjak	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens)	x-0525441 y-4668999 z-696	Kategoria III Monument I natyrës me karakter botanik
4.	Pustenik	Kepi i gjatë dhe burimi i ujit	x-0520640 y-4669909 z-612	Kategoria III Monument I natyrës me karakter geom.-hidrologjik

### VLERËSIMET NGA DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJA E MJEDISIT

Pas shqyrtimit të komenteve të paraqitura gjatë debatit publik, Drejtoria konstaton se:

- Monumentet e propozuar përmbushin kriteret për mbrojtje,
- Ka përkrahje të gjërë nga komuniteti,
- Nevojitet ndërmarrja e hapave të mëtejshme për regjistrim, sinjalizim dhe promovim të tyre.

## PËRFUNDIM

Ky raport do të shërbejë si dokument bazë për hapat e mëtejshme administrative dhe ligjor lidhur me mbrojtjen e këtyre vlerave të trashigimisë natyrore në Komunën e Hanit të Elezit.

Hani i Elezit  
11.03.2026



## MONUMENTET E TRASHIGIMISW NATYRORE- KOMUNA E HANIT TW ELEZIT

### 1. Parku dhe Ujëvara në qytetin e Hanit të Elezit.



#### 1.2. Lloji i monumentit

Monument Natyror me karakter hidrologjik.  
(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

#### 1.3. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

1.4 Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

#### 1.5. Pozita

Monumenti Natyror Parku dhe Ujëvara ndodhet në pronë shoqërore dhe ka pamje karakteristike.

Sipas matjeve me GPS Parku dhe Ujëvara ndodhet në koordinatat:

X = 0525138

Y = 4666926

Lartësia mbidetare = 412 metra

### **1.6. Kufijtë**

Sipërfaqja ku ndodhet Monumenti i Natyrës Parku dhe Ujëvara nëqytetin e Hanit të Elezit, gjendet në parcelën 00061-16, zona kadastrale Hani i Elezit, nr. P-73317036-00061-16, me sipërfaqe 4.76 hektar, e regjistruar si pronë shoqërore dhe gjendet në afërsi të depos së vjetër ushtarake (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, në Hanin e Elezit).

### **1.7. Sipërfaqja**

Sipërfaqja e Monumentit Natyror të Parkut dhe Ujëvarës përfshinë hapësirën prej një 0.27 hektar, si zonë që propozohet për mbrojtje.

## **2. Kanioni në fshatin Dremajk të komunës së Hanit të Elezit.**



## 2.1. Lloji i monumentit

Monument Natyror me karakter hidrologjik.  
(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

## 2.2. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

2.3. Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

## 2.4. Pozita

Monumenti Natyror Kanioni ndodhet në pronë shoqërore dhe ka pamje karakteristike.

Sipas matjeve me GPS Kanioni ndodhet në koordinatat:

X = 0526019

Y = 4668755

Lartësia mbidetare = 607 metra


## 2.5 Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Monumenti i Natyrës Kanioni në fshatin Dremjak të komunës së Hanit të Elezit, gjendet në parcelën 00574-0, zona kadastrale Dremjak, nr. P-73317034-00574-0, me sipërfaqe 18695 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pronë shoqërore (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, në Hanin e Elezit).

## 2.6. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit Natyror Kanioni përfshinë hapësirën prej **0.24 hektar**, si zonë që propozohet për mbrojtje.

**3. Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) në fshatin Dremajk të komunës së Hanit të Elezit**



**3.1. Lloji i monumentit**

Monument Natyror me karakter botanik.  
(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

### 3.2. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

3.3. Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

### 3.4. Pozita

Monumenti Natyror Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) ndodhet në pronë shoqërore dhe ka pamje karakteristike.

Sipas matjeve me GPS trungu ndodhet në koordinatat:

X = 0525441

Y = 4668999

Lartësia mbidetare = 696 metra

### 3.5. Kufijtë


Sipërfaqja ku ndodhet Monumenti i Natyrës Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) në fshatin Dremjak të komunës së Hanit të Elezit, gjendet në parcelën 00371-0, zona kadastrale Dremjak, nr. P-73317034-00371-0, me sipërfaqe 8960 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pronë shoqërore (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, në Hanin e Elezit).

Si kufi për Monumentin e Natyrës –Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) në fshatin Dremjak të merret diametri i rrezes rreth 12.5 metra nga të gjitha anët (S = 500 m<sup>2</sup>).

### 3.6. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit Natyror përfshinë hapësirën në të cilën gjendet Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) si dhe hapësirën përreth, si zonë mbrojtëse (zonë buferike). Propozohet për mbrojtje sipërfaqja prej **5 ari**.

#### 4. Kepi i gjatë dhe burimi i ujit në Lagjen Laq- Pustenic të Hanit të Elezit



#### 4.1. Lloji i monumentit

Monument Natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik.  
(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

#### 4.2. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

- 4.3. Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

#### 4.4. Pozita

Monumenti Natyror Kepi i gjatë dhe burimi i ujit ndodhet në pronë shoqërore dhe ka pamje karakteristike.

Sipas matjeve me GPS Kepi i gjatë dhe burimi i ujit ndodhet në koordinatat:

X = 0520640

Y = 4669909

Lartësia mbidetare = 612 metra

#### 4.5. Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Monumenti i Natyrës Kepi i gjatë dhe burimi i ujit nëfshatin Pustenic të Hanit të Elezit, gjendet në parcelën 00099-0, zona kadastrale Pustenic, nr. P-73317070-00099-0, me sipërfaqe 266189 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pronë shoqërore (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, në Hanin e Elezit).

#### 4.6. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit Natyror Kepi i gjatë dhe burimi i ujit përfshinë edhe hapësirën përreth. Propozohet për mbrojtje sipërfaqja prej **10.80 hektar**.